



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RENISË

Nr. 6778 prot.

Himarë, më 04.09.2025

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “ Për ofrimin e shërbimeve lëvizëse për individë dhe familje në nevojë në Bashkinë Himarë ”.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ✓

Po ju dërgojmë për miratim projektvendimin “ Për ofrimin e shërbimeve lëvizëse për individë dhe familje në nevojë në Bashkinë Himarë ”.

Bashkëngjitur do të gjeni projektvendimin, relacionin sqarues dhe përshkrimin e projekt-propozimit.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!


KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

ME DELGIM DHE ME URDHR

ZEVENDESKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 8778 / prot.

Himarë, më 04.09.2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 47, datë 04.09.2025

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKT-PROPOZIMIT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE
LËVIZËSE PËR INDIVIDË
DHE FAMILJE NË NEVOJË NË BASHKINË HIMARË”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”; nenit 24; nenit 54, shkronja “k”; dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt-propozimit për ofrimin e shërbimeve lëvizëse për individë dhe familje në nevojë në Bashkinë Himarë, i përfshirë në Planin Social Vendor. Dokumenti bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare për zbatimin e projekt-propozimit do të përballohen nga buxheti vjetor i Bashkisë Himarë dhe fondet e dedikuara nga buxheti i shtetit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mbështesë bashkinë në vitin e parë me 90% të kostos totale të projektit, ndërsa bashkia do të përballojë 10%. Në vitin e dytë, Ministria do të kontribuojë 60% dhe bashkia 40%, dhe në vitin e tretë Ministria 30%, ndërsa bashkia mbulon pjesën tjetër të kostos së projektit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë, si dhe Drejtoria e Financës dhe e Planifikimit të Buxhetit për ndjekjen, monitorimin dhe zbatimin e projekt-propozimit sipas objektivave dhe afateve të parashikuara.

Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

ME DELGIM DHE ME URDHER

ZEVENDESKRYETARI

Erifili Berberi



DREJTORI

Nestur Velço

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 5718/2 prot.

Himarë, më 04.09.2025

RELACION SQARUES

Lënda: “Për miratimin e projekt-propozimit për ofrimin e shërbimeve lëvizëse për individë dhe familje në nevojë në Bashkinë Himarë”

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Në kuadër të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe “Planit Social Vendor 2025-2028 të Bashkisë Himarë” miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak me nr.39, datë 31.07.2025, Bashkia Himarë ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për garantimin e aksesit të barabartë në shërbime sociale për të gjithë shtetasit, me fokus të veçantë tek individët dhe grupet vulnerabël.

Territori i Bashkisë Himarë përfshin një hapësirë të gjerë gjeografike, ku shumë fshatra dhe zona rurale kanë akses të kufizuar në shërbime publike dhe sociale. Individë të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, familje me të ardhura të ulëta dhe qytetarë në kushte të vështira sociale shpesh përballen me pamundësi për të marrë shërbimet bazë për shkak të distancës, mungesës së transportit, apo kushteve të tjera ekonomike dhe shëndetësore.

Për të adresuar këto problematika, projekti “Ofrimi i shërbimeve lëvizëse për individë në nevojë” synon:

- Sigurimin e shërbimeve bazë sociale, psikologjike dhe këshilluese pranë komuniteteve të izoluar;
- Lehtësimin e barrës ekonomike dhe sociale të familjeve në nevojë duke iu sjellë shërbimet pranë vendbanimit;
- Promovimin e barazisë në akses dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël, sipas parimit të mosdiskriminimit dhe gjithëpërfshirjes;
- Zbatimin e planit vendor për zhvillimin e shërbimeve sociale.

Ky projekt është i një rëndësie të veçantë pasi krijon mundësi të reja për shtrirjen e shërbimeve në çdo cep të Bashkisë Himarë, duke garantuar që asnjë individ në nevojë të mos mbetet pa mbështetjen e duhur institucionale. Për më tepër, ofrimi i shërbimeve lëvizëse është një mënyrë efektive dhe me kosto të ulët për të kompensuar mungesën e qendrave të përhershme në të gjithë territorin. Në këto kushte, miratimi i këtij projekt-propozimi nga Këshilli Bashkiak është i domosdoshëm për përmirësimin e cilësisë së jetës së individëve në nevojë dhe për forcimin e rolit të Bashkisë në sigurimin e shërbimeve sociale të aksesueshme dhe të qëndrueshme.

Për sa u parashtrua më sipër dhe në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", kërkojmë miratimin e projektit.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo


ME DELGIM DHE ME URDHER

ZEVENDESKRYETARI

Erifili Berberi

DREJTORI

Nestur Velço



DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE SOCIALE, ARSIMIT DHE RINISË

Nr. 6778/13 prot.

Himarë, më 04.09.2025

PROJEKT-PROPOZIM

“PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE LËVIZËSE PËR INDIVIDË DHE FAMILJE NË NEVOJË NË BASHKINË HIMARË”

Ky projekt ka për qëllim krijimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale të strukturuar dhe lëvizëse, duke siguruar akses të barabartë për familjet në nevojë, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara (PAK), viktimat e dhunës, përdoruesit e substancave, dhe kategori të tjera vulnerabël. Projekti synon shpërndarje të barabartë të shërbimeve dhe adresim të nevojave imediate të grupeve në risk.

Objektivat e projektit

- Garantimi i shërbimeve sociale lëvizëse në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë.
- Zhvillimi i një sistemi të integruar për ndërhyrje emergjente sociale dhe natyrore.
- Ofrimi i mbështetjes psikosociale për fëmijët, PAK, të moshuarit dhe familjet në nevojë.
- Krijimi i një platforme elektronike për identifikimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve sociale.

Masat dhe aktivitetet kryesore

Masa 2.1 – Ngritja e shërbimit lëvizës nëpërmjet krijimit të njësisë sociale lëvizëse *Aktivitetet:*

- 2.1.1 Ngritja e njësisë sociale lëvizëse, përfshirë sigurimin e burimeve financiare dhe logjistikës (mjet transporti, pajisje teknologjike, materiale pune).
- 2.1.2 Rekrutimi dhe trajnimi i stafit të njësisë për ofrimin e shërbimeve sociale dhe emergjente.
- 2.1.3 Hartimi i protokolleve të operimit për vizitat në terren dhe menaxhimin e rasteve në zona të thella.

- 2.1.4 Hartimi dhe zbatimi i kalendarit vjetor të vizitave për mbulim të gjithë njësive administrative.
- 2.1.5 Fillimi i shërbimeve në terren dhe monitorimi i performancës së njësisë.

Treguesit:

- Njësia lëvizëse funksionale brenda vitit të dytë.
- Strukturë organizative dhe plan pune i miratuar.
- Minimumi 1 automjet dhe pajisje teknologjike të nevojshme.
- Të paktën 4 specialistë të rekrutuar dhe trajnuar.
- Minimumi 3 protokolle operimi të zbatuara.
- Kalendar vjetor i vizitave i hartuar dhe i miratuar.
- Minimumi 100 vizita sociale në vitin e tretë.

Masa 2.2 – Zhvillimi i një sistemi të integruar për ndërhyrje emergjente sociale dhe natyrore

Aktivitetet:

- 2.2.1 Hartimi dhe miratimi i protokollit të integruar për reagim në emergjenca sociale dhe natyrore.
- 2.2.2 Trajnimi i stafit dhe partnerëve lokalë për zbatimin e protokollit.
- 2.2.3 Krijimi i rrjetit të bashkëpunimit mes njësive administrative, institucioneve vendore dhe OJF-ve.

Treguesit:

- 1 protokoll i integruar i miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- Të paktën 2 trajnime të realizuara.
- Minimumi 30 pjesëmarrës të trajnuar.

Masa 2.3 – Program integruar për mbështetje psikosociale për fëmijët, PAK dhe të moshuarit

Aktivitetet:

- 2.3.1 Hartimi i programit të integruar psikosocial.
- 2.3.2 Formimi dhe trajnimi i ekipit multidisiplinar (punonjës socialë, psikologë, infermierë).

Treguesit:

- Programi i hartuar dhe miratuar brenda vitit të parë.
- Të paktën 6 specialistë të trajnuar.
- Minimumi 2 sesione trajnime në vit.

Masa 2.4 – Zhvillimi i një sistemi elektronik për menaxhimin e rasteve sociale

Aktivitetet:

- 2.4.1 Projektimi dhe zhvillimi i platformës elektronike për menaxhimin e rasteve.
- 2.4.2 Trajnimi i stafit për përdorimin e platformës.
- 2.4.3 Implementimi dhe integrimi i platformës me sistemet ekzistuese të bashkisë.

Treguesit:

- Platforma funksionale brenda vitit të dytë.
- Minimumi 3 ditë trajnim për përdorim.
- Minimumi 10 punonjës të trajnuar.
- Minimumi 100 raste të regjistruara dhe ndjekura në vit.
- Raporti vjetor mbi funksionimin dhe efektivitetin e platformës.

3. Burimet financiare

Projekt-propozimi do të mbështetet nga buxheti vjetor i Bashkisë Himarë dhe fondet e dedikuara nga buxheti i shtetit, sipas përqindjeve të përcaktuara për secilin vit të zbatimit të projektit.

5. Koordinimi dhe monitorimi

Ngarkohen Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë dhe Drejtoria e Financës dhe e Planifikimit të Buxhetit për ndjekjen, monitorimin dhe raportimin e zbatimit të projektit sipas objektivave dhe afateve të përcaktuara.

Bashkëngjitur do të gjeni buxhetin e parashkuar për këtë projekt propozim.

DREJTORI

Nestur Velço

